REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
08.06.2020

| Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit | Šnif.klasif. / Klasif. Kod / Class. Code | Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. | Nr.i faqove / Br. Stranica / No. Pages |
|---|---|---|---|
| 04 | 47 | 752 | 7 |

REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS
IZLAZNI - DALËSE
03/Br.Prot. Nr.Prot. 02-030/01-4334/20
Br.str. Nr.i fq. 1
Datum Data 29.05.2020.
ŠTRPCE - SHTËRPCË

Për Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga z.Bratislav Nikolić, Kryetar I Komunës Shtërpcës

# PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

## të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për 2019

| Nr. | Komponenta e auditimit(kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë | Zyrtari/ët përgjegjës | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Të hyrat | Ligji numër 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 15 pika 2 kërkon që veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të komunës. Nga 3,850 prona të evidentuara në bazën e të dhënave mbi tatimin në pronë, komuna kishte arritur të verifikoj vetëm 36 prona aktuale të regjistruara, apo 1%. Kjo kishte ndodhur për shkak që zyrtarët komunal kishin pasur probleme në funksionimin e pajisjeve, mungesa e tabletit, trajnimi për program dhe mos funksionim i rrjetit | Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se pajisjet futen në funksion dhe mbahen trajnimet për përdorim të programit si dhe inspektimi i objekteve për tatimit në pronë të bëhet sipas ligjit, në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. | Hapi 1<br><br>Furnizimi me pajisje edeukate<br><br>Hapi 2<br><br>Punë në terren | Drejtoria për Buxhet dhe Financa- Zyra e tatimit në pronë (Bojan Sharkoqeviq dhe Jenuz Murtezi ) | 05.05.2020<br><br>31.12.2020 | Drejtoria e Financave është furnizuar me pajisje adekuate, megjithatë, në lidhje me aktivitetet e inspektimit për shkak të situatës emergjente të shkaktuar nga virusi korona (covid 19), ka pak hapësirë për zbatimin e këtij rekomandimi gjatë vitit 2020. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Të hyrat | Komuna nuk kishte bërë korrigjimet në dy raste të identifikura në raportin e vitit të kaluar. Në rastin e parë kartela financiare ka paraqitur një evidentim të gabuar të pagesës së pa realizuar. Sipas kartelës financiare, tatimpaguesi pagoi në emër të tatimit në pronë për 2018 vlerën prej 4,323€, derisa në raportin kësaj e të hyrave nuk figuron fare. Borxhi real i këtij tatimpaguesi për vitin 2018 kap shumen prej 3€ derisa në fund të vitit tatimpaguesi ishte në parapagim në vlerë prej 4,320€. Zyrtarët kishin bërë kërkesë për korrigjimin e gabimit të lëshuar, por ende nuk janë bërë përmirësimet e nevojshme; dhe Në rastin tjetër në sistem nuk janë përllogaritur të dhënat për tatimpaguesin. Për kategorinë e objektit, Fermës së Peshkut në zonën e IV është përcaktuar vlera prej 100€ për m2, në vend të 350€ për m2 siç është e paraparë. Zyrtarët përgjegjës nuk kishin kryer obligimin e zotuar përmes planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. | Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës bëjnë rregullimet e gabimeve në bazën e të dhënave për tatim në pronë të në pajtim me ligjet dhe rregulloret. | hapi 1<br><br>Kontrollimi i informacionit të dhënë<br><br>hapi 2<br><br>korigjimi i gabimit të cekur | Drejtoria për Buxhet dhe Financa- Zyra e tatimit në pronë (Dejan Dobrosavljeviq dhe Ramadan Halimi) | 31.12.2020<br><br>31.12.2020 | Zyra e tatimit në pronë do të punojë për të korrigjuar gabime të cekura në periudhën e ardhshme. |
| 3 | Të hyrat | Sipas nenit 3 të Rregullores komunale për taksa, kërkohet që pas regjistrimit të veprimtarisë afariste përcaktohet shuma vjetore e taksës me aktëvendim dhe i dorëzohet subjekteve afariste më së voni një muaj para fillimit të vitit kalendarik. Komuna e Shtërpcës nuk kishte arritur për vitin 2019 ti faturoj bizneset me taksë në biznes. Neve nuk na është ofruar vlera e pa faturuar. Kjo gjendje ishte për shkak | Rekomandimi A2 Kryetari të siguroj që zyrtaret përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje | hapi 1<br><br>Shtypja e zgjidhjeve të cekura<br>hapi 2<br><br>Shpërndarja e zgjidhjes | Drejtoria për Buxhet dhe Financa– Zyrtari për Taksa Komunale Zharko Simiq | 31.09.2020<br><br>31.12.2020 | Ne pajtohemi me rekomandimin e auditimit, por për shkak të situatës së krijuar me Covid- 19 realizimi i rekomandimit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës. | ngarkesën e taksës së biznesit dhe dorëzimin e vendimeve te subjektet afariste. | | | | do të bëhët në pjesen e dytë të vitit |
| 4 | Pagat dhe mëditjet | Sipas Nenit 12, paragrafi 4 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin civil, kërkohet të aplikohen procedura e thjeshtësuar e punësimit për marrëveshje për shërbime të veçanta. Komuna vazhdon të angazhoj të punësuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta pa përdorur procedurë për rekrutim, ku kishte angazhuar avokatin komunal i cili trajtohet me ligjin e shërbyesve civil. Kjo kishte ndodhur për shkak se në departamentin e administratës nuk kishte pozita të lira. | Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë se në të gjitha rastet për marrëveshjet për shërbime të veçanta të aplikohen procedura të thjeshtësuara të rekrutimit. | | Zyra kryetarit– SHef personelit Irena Milenkoviq | 05.05.2020 | Rekomandimi është duke u zbatuar |
| 5 | Subvencionet dhe transferet | Marrëveshja në mes të komunës dhe përfituesit të subvencionit në nenin 4 obligimet e përfituesit përcakton se përfituesi duhet të sjell tek autoriteti kontraktues, raportin me shkrim si dhe raportin financiar për mjetet e shpenzuara. Në katër nga pesë mostrat e testuara në vlerë të përbashkët prej 1,000€, përfituesit e subvencioneve nuk kishin përgatitur raporte financiare dhe nuk kishin ofruar dëshmi, të cilat do të dëshmonin se subvencioni është shfrytëzuar për qëllimin e dhënë. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së | Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e subvencionev e raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve sipas kritereve të përcaktuara në marrëveshje, | | Zyra kryetarit në bashkëpunim me Drejtorin e financave – Dejan Raciqeviq | 05.05.2020 | Rekomandimi është duke u zbatuar |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | zyrtarëve përkatës në zbatimin e kërkesave të marrëveshjes në rast të mos raportimit. | në të kundërtën të zbatohen kërkesat e marrëveshjes në rast të mos raportimit. | | | | |
| 6 | Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet , si dhe investimet kapitale | Sipas, nenit 14 të Rregullores së MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore kërkohet që te pjesa e hyrjes së parasë së gatshme të prezantohen të hyrat që komuna ka planifikuar/arkëtuar gjatë vitit. Te shënimi 12, hyrja e parasë së gatshme huamarrja është prezantuar gabimisht si buxhet fillestar 24,000€, buxhet final 31,000€ dhe si realizim 12,000. I njëjti gabim është bartur edhe te neni 14.6 për vlerën e buxhetit fillestar. Ne i kemi këshilluar zyrtarët e komunës për largimin e vlerave nga shënimi 12, mirëpo kjo është refuzuar nga komuna. | Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se financimi nga huamarrja prezantohet në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore. | hapi 1<br><br>Ngritja e kësaj çështje me persona kompetent nga Min. Financëve | Drejtoria për Buxhet dhe Financa–Drejtori i drejtorisë Danijel Vuksanoviq | 31.12.2020 | Drejtori i drejtorisë së Buxhetit dhe Financave pajtohet me rekomandimin e auditimit, megjithatë dhënat janë paraqitur ashtu siç kërkohet nga personat përgjegjës të Ministrisë së Financave dhe si ashtu janë pranuar si dhënat të tillë e verteta dhe i sakta. |
| 7 | Pasuritë kapitale dhe jo kapitale | Sipas nenit 4 Rregullores nr. 02/2013, Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Komuna ende nuk posedon procedura të brendshme për | Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë shtuar kontrollet në menaxhimin | hapi 1<br><br>Formimi i komisionit | Zyra kryetarit–Nënkryetari i komunës Ivica Tanasijeviq dhe komisioni që do të emërohet për regjistrimin dhe | 30.06.2020 | Pajtohrmi me rekomandimin e auditorëve . |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | menaxhimin e pasurisë; Rregullorja për menaxhimin e pasurisë nr. 02/2013, te neni 19 dhe neni 21 kërkon që të formohet komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurisë. Edhe në këtë vit nuk ishte zbatuar kërkesa e rregullores për formim të komisioneve; Në PVF te neni 19.3.3 kërkohet të bëhet shpalosja e stoqeve në posedim të komunës. Vlera prej 5,526€ e prezantuar në PVF, paraqet vetëm vlerën e stoqeve në objektin e komunës. Ndërsa stoku që gjendej në objektet e shëndetësisë dhe arsimit nuk është prezantuar për shkak se nuk i është nënshtruar procesit të numërimit. Kjo ka ndodhur për shkak mungesës së njohurive, neglizhencës dhe refuzimit të zyrtarëve për angazhim në komisione. | dhe raportimin e pasurisë, që menaxhimi dhe raportimi të zbatohet në përputhshmër i me kërkesat ligjore. | hapi 2<br><br>Regjistrimi dhe vlerësimi i pasuris | vlerësimin | 31.12.2020 | |
| 8 | Pasuritë kapitale dhe jo kapitale | Sipas nenit 2.1 të Rregullores 02/2013, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Gjatë testimit të 3 nga 12 pagesat për vitin 2019 kemi pare që komuna kishte blerë pajisje mjekësore speciale në vlerë 299,228€, mirëpo gjatë ekzaminimit fizik kemi vërejtur se pajisjet ishin vendosur në depo duke mos i futur në përdorim. Në regjistrin e pasurive të | Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që zbatohet mirë planifikimi i nevojave për prokurim para se të kërkohet dërgesa e çfarëdo malli apo pajisjeve të kërkuara me qëllim të menaxhimit adekuat të | | Shëndetësia Sekondare personi përgjegjes v.d drejtor Zlatko Stanojeviq | 31.12.2020 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shëndetësisë sekondare janë të evidentuara pajisje mjekësore në vlerë totale 461,873€, të cilat pajisje janë të pa përdorura por vazhdojnë të zhvlerësohen. Zhvlerësimi i akumuluar i tyre deri në vitin 2019 arrin vlerën 57,040€. Nga ky konstatim shihet se pajisjet e kanë humbur vlerën e tyre ende pa u përdorur. Kjo kishte ndodhur për shkak se nuk ishte bërë vlerësimi jo adekuat i nevojave për arsye se ndërtesa (Spitali) në të cilin duhet të vendosen pajisjet ende nuk është përfunduar. | buxhetit. | | | | |
| 9 | Të arkëtueshmet | Sipas ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme me nenin 30 pika 1 është përcaktuar se nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e treqind (300) Eurove. Vendimi merret brenda dhjetë (10) ditëve pune. Sipas raportit Ministrisë së Financave borxhet ndaj komunës për tatim në pronë janë në vlerë 2,116,653€, pavarësisht kësaj, komuna ka arritur që deri në fund të vitit 2019 të arkëtojë vlerën prej 182,612€ apo rreth 9% nga vlera totale e borxhit. Përndryshe, borxhet për tatimin në pronë nga viti në vit janë në rritje të vazhdueshme. | Rekomandimi B2 Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë dhe taksa në biznes, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre. | hapi 1<br><br>Shpërndarja e faturave dhe aktvendimeve | Drejtoria për Buxhet dhe Financa- Zyra e tatimit në pronë –<br>Dejan Dobrosavljeviq i Zyrtari për Taksa Komunale Zharko Simiq | 31.12.2020 | Për shkak të situatës aktuale të shkaktuar nga virusi Covid - 19 deri më tani, asnjë faturë tatimore nuk është shpërndarë ende. Për shkak të situatës me të cilën përballemi të gjithë, rekomandimi do të zbatohet në gjysmën e dytë të vitit 2020, nëse lejojnë kushtet. |